



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE E GJELBËRIMIT
DREJTORIA PLANIFIKIMEVE MENAXHIMIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: **“GERARD-A”sh.p.k me Nipt: L12407005L** me Adresë:Rruga “Ded Gjo Luli” me pasurinë e paluajtshme nr.6/901,Zona Kadastrale 8350,vol38,faqe211,Tiranë, me Administrator Z. Sokol Kryeziu .

- 1.Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur”**
- 2.Numri i References se Proçedures: **REF-58216-05-15-2020**
- 3.Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje mjete transporti dhe agregat”.**
4. Fondi Limit: **12 500 000** (dymbëdhjetë milion e pesëqind mijë) **lekë pa tvsh**
5. Burimi i të ardhurave: **Bashkia Tiranë.**
6. Kohëzgjatja e kontratës: 10 ditë nga data e lidhjes së kontratës
7. Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët
8. Data e zhvillimit të procedures: **10.06.2020 ora 11:00**

Njoftojme se kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik **“GERARD-A” me Nipt: L12407005L** me ofertë ekonomike , 11 000 000 (njëmbëdhjetë milion) lekë pa tvsh ,13 200 000 (trembëdhjetë milion e dyqind mijë) lekë me tvsh.

2.Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “ LUAR BROS” sh.p.k me Nipt: L72322004M me ofertë ekonomike 9 672 000 (nëntë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë pa tvsh ,11 606 400 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtë mijë e katërqind mijë) lekë me me tvsh.

3.Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “POWER INDUSTRIES” sh.p.k me Nipt: L51706022H me ofertë ekonomike 11 900 000 (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind mijë) lekë pa tvsh14 280 000 (katërbëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë me tvsh.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “ LUAR BROS” sh.p.k

Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi “ LUAR BROS” sh.p.k nga ku rezulton se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
- Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST

1.OE Luar Bros nuk ka firmën e përkthyesit tek dokumentacioni i paraqitur, e gjithashtu nuk është e qartë çfarë dokumenti është përkthyer pasi nuk cilësohet në dokumentacionin e paraqitur. Më tej gjuha tek vërtetimi i përkthimit i dates 10/06/2020 Nr REP 5319 nuk është gjermanisht (deustch) por hollandisht (dutch) tek librezat e qarkullimit të paraqitura. Gjithashtu ka mospërputhje në përkthim tek mjeti Autokullë (Platëformë Pune) pasi në anglisht çmimi është 32000 Euro ndërsa në shqip është 30500 Euro.

2. Gjithashtu të gjitha marrëveshjet apo kontratat që OE Luar Bros pretendon se ka nënshkruar me OE të huaj nuk përmbajnë date në asnjë prej rasteve.

3. OE Luar Bros nuk përmbush pikën 4 të specifikimeve teknike pasi kamionçinat e paraqitura të markës Renault Master me numër shasie përkatësisht (VAFQMBH4S551168619) dhe (VF1MBH4V55458845) nuk janë të llojit vetë-shkarkuese në asnjërin prej rasteve në dokumentacionin e paraqitur, siç edhe janë kërkuar nga AK në dokumentat e tenderit. Kamionçinat nuk janë vetë-shkarkuese pra nuk janë të llojit kipper siç edhe cilësohet në gjuhë hollandeze nëse ato do të ishin të tilla.

4. OE Luar Bros nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit teknik pasi pas verifikimeve të kryera nga ana e KVO mbi dokumentacionin e dërguar dhe specifikisht mbi mjetin Renault Master me nr. shasie VF1MBH4V550458845 ky mjet nuk rezulton të ketë 125, 595 km.

5. OE Luar Bros nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit Teknik në lejen e qarkullimit të mjetit Autokullë (Platëformë Pune) ku shkruhet se është dy metra e gjërë ndërkohë që në përkthim të kontratës është 1.8 metra. Gjithashtu sipas specifikimeve teknike kulla kërkohet të jetë maksimumi 1.9 metra e gjërë ndërkohë që është 2 metra e gjërë sipas librezës së qarkullimit. Gjithashtu nuk përmbush specifikimet teknike pasi gjatësia është 5522 mm (ose 552,2 cm) ndërkohë që sipas specifikimeve teknike

gjatësia duhet të jetë 450-500 cm.

6. OE Luar Bros nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit Teknik pasi kamionçinat janë 3500 kg ndërkohë që nga AK janë kërkuar 2900-3400 kg.

7. Mos-përputhje nga dokumentacioni i paraqitur për kamionçinën Renault Master me numër shasie përkatësisht (VF1MBH4V55458845) ku vëllimi i paraqitur tek dokumentat e përkthyer nuk korrespondon me atë të paraqitur në lejen e qarkullimit, ku specifikisht në dokumentacionin e përkthyer të paraqitur është 2298 cm³ ndërkohë që në lejen e qarkullimit është 2299 cm³.

2.Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “POWER INDUSTRIES” sh.p.k

Shqyrtohet oferta e paraqitur nga ofertuesi : “POWER INDUSTRIES” sh.p.k nga ku rezulton se:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
- Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST

1.OE Poëer Industries nuk përmbush pikën 4 të Kapacitetit Teknik pasi kamioni me kosh I llojit Nissan Cabstar me Nr. shasie VËGASFF24B1051562 ka një gjatësi prej 5470 mm (ose 547 cm) ndërkohë që nga AK në specifikimet teknike është kërkuar 450-500 cm, gjithahshu gjerësia e kërkuar në specifikime teknike nga AK është jo më shumë se 190 cm ndërkohë që gjerësia e mjetit Nissan Cabstar me Nr. shasie VËGASFF24B1051562 është 2100 mm (ose 210 cm).

2. Kamionçinat vetë-shkarkuese nuk përmbushin specifikimet teknike të kërkuara pasi në specifikime teknike AK ka kërkuar që pesha e autorizuar të jetë 2900-3400 kg ndërkohë që sipas dokumentacionit të paraqitur nga OE Poëer Industries kamionçinat vetë-shkarkuese e tejkalojnë këtë peshë pasi pesha e autorizuar është 3500 kg.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se operatori ekonomik “GERARD-A” shpk me adresë Rruga “Ded Gjo Luli” me pasurinë e paluajtshme nr.6/901,Zona Kadastrale 8350,vol38,faqe211,Tiranë, me Administrator Z. Sokol Kryeziu se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 11 000 000 (njëmbëdhjetë milion) lekë pa tvsh dhe 13 200 000 (trembëdhjetë milion e dyqind mijë) lekë me tvsh. është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit të Qytetit, Tiranë sigurimin e kontratës, dhe nënshkrimin

e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Klasifikimi u bë me datë **12.06.2020** në sistemin elektronik të APP-së

Ankesa: Nuk ka

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Arlinda Binjaku